



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15.7.2024

Nr: 87

Ora: 18:00

V E N D I M

P Ë R

**NGRITJEN DHE THIRRJEN E MBLEDHJES SË PARË TË KOMISIONIT TË ZONËS  
SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR. 88, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR  
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “b” dhe “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Ngritjen e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024.
2. Mbledhja e parë e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, do të zhvillohet në selinë e KZAZ-së, njësia administrative Himarë, Rruga Apelistra, Zyrat e Këshillit Bashkiak, stadiumi “Petro Ruci”, në datën 16.7.2024.
3. Bashkia Himarë do të sigurojë infrastrukturën logjistike në selinë e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 3 vjet

S.Bregasi \_\_\_\_\_  
E.Meta \_\_\_\_\_  
M. Koja \_\_\_\_\_  
M. Çelmeta \_\_\_\_\_

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 15.7.2024 Nr: 87  
Ora: 18:00



“Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor nr. 88, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”